

Komente dhe rekomandime të qytetarëve nga diskutime publike

Data: 08.11.2022

Drejtuar: Zj. Laura Shehu, Udhëheqëse e Divizionit për Shëndet Mendor

Nga 26.10.2022, deri në 4.11.2022, OJQ "Qendra për Informim dhe Përmirësim Social" (QIPS), duke u mbështetur nga CDF dhe me përkrahje nga anëtarë të ndryshëm të shoqërisë civile, kemi zhvilluar diskutime publike me qytetarët e Kosovës në 7 qytete të ndryshme. Ato janë: Prishtinë, Gjiilan, Gjakovë, Ferizaj, Prizren, Mitrovicë dhe Pejë.

Qytetarët janë ftuar direkt apo nëpër rrjete sociale për të marrë pjesë. Pjesëmarrja ka qenë e kënaqshme duke e pasur parasysh mobilizimin e shpejtë dhe resurset rreth kësaj çështje dhe ka qenë aktive nga ana e qytetarëve të cilët me përkushtim kanë marrë pjesë në diskutime në mënyrë që zëri i tyre të dëgjohet karshi Koncept Dokumentit për Shëndet Mendor.

Më poshtë janë komentet dhe rekomandimet e qytetarëve të renditur në mënyrë të rëndomtë. Jo të gjitha janë të aplikueshme në Koncept Dokumentin për Shëndet Mendor, sidoqoftë e konsiderojmë të vlefshëm çdo koment të qytetarëve, rrjedhimisht janë përfshi në këtë dokument për tu shqyrtuar nga ana e juaj.

Lista e komenteve dhe rekomandimeve

- Të rregullohet me ligj linja për parandalimin e vetëvrasjes.
- Të përfshihen grupet pakicë (LGBT+, pakice etnike, fetare, etj.) në punimet e radhës të Ministrisë së Shëndetësisë, në mënyrë që të ketë gjithëpërfshirje të përvojave.
- Të ketë informata më moderne rreth situatës aktuale të shëndetit mendor në Koncept Dokument.
- Të mendohet në baza të veçanta trajtimi i pedofilisë.
- Të hartohen standarde për raportimin e vetëvrasjeve në media.
- Të ketë monitorim të cilësisë të psikologëve klinik, psikologëve shkollor dhe psikiatërve.
- Të ketë degëzime të specializime për licencim për psikolog përtej psikologëve klinik, shkollor apo këshillues.
- Të ndalohet me ligj trajtimi i personave LBGTI+ për "shërim".
- Të përfshihen veteranët në Koncept Dokumentin për Shëndet Mendor.
- Të përfshihen palët profesioniste të tjera në hartimin e dokumenteve nga MSH.
- Të elaborohet më shumë në Koncept Dokument për Shëndet Mendor trajtimi i viktimave të dhunës në baza gjinore.
- Në koncept dokument mungon përfshirja e Qendrave për Punë Sociale dhe strehimoreve.
- Të elaborohen më shumë llojet e dhunës dhe trajtimet e ndryshme për ta.
- Të përfshihen viktimat e trafikimit.
- Të përfshihen institucione tjera relevante, siç është MASHT.

- Të ketë më shumë informata rreth personave të cilët ballafaqohen me forma të ndryshme të depresionit.
- Ka një mungesë të profesionistëve të shëndetit mendor në spitale, së bashku me informimin e qytetarëve për shërbimet të cilët i ofrojnë. Të punohet në përmirësimin e këtij problemi.
- Të decentralizohen shërbimet psikiatrike dhe të shëndetit mendor nga qytetet/komunat.
- Janë raportuar raste të burgimit të individëve të cilët kanë çrregullime të shëndetit mendor në momente kur ka dështuar psikiatria në ofrimin e shërbimeve. Të informohen qytetarët mbi pikat se ku mund të kërkojnë ndihmë në raste të tilla dhe të merren hapa proaktive në parandalimin e situatave të tilla.
- Të ketë më shumë shërbime të shëndetit mendor të cilat fokusohen në komunitet.
- Të ketë më shumë ndjeshmëri etnike dhe ndjeshmëri mbi komunitetin LGBTI+ nga profesionistët e shëndetit mendor.
- Të ketë trajnime të psikologëve klinik, psikologëve shkollor dhe psikiatërve mbi trajtimin e qytetarëve të komuniteteve pakicë.
- Të funksionalizohet një linjë emergjente për shëndetin mendor dhe parandalimin e dhunës tek fëmijët.
- Të praktikohen teste të shëndetit mendor në vende të punës publike (me fokus të veçantë në institucione shëndetësore dhe arsimore), me qëllim identifikimin e personave të cilët kanë nevojë për mbështetje dhe ofrimin e shërbimeve tek ta.
- Të ofrohet më shumë përkujdesje ndaj shëndetit mendor të personelit shëndetësor, siç janë infermierët dhe mjekët.
- Të informohen më shumë qytetarët rreth shërbimeve të shëndetit mendor të cilat ofrohen nga institucionet e Kosovës.
- Të ketë monitorim mbi klinika private të shëndetit mendor.
- Të formohet një qendër rehabilituese për gra që janë përdoruese të drogës.
- Karshi trajtimit për varësi, të trajtohet gjithashtu varësia ndaj lojërave.
- Të përfshihen personat e pa strehë dhe nevojat e tyre në Koncept Dokumentin për Shëndet Mendor.
- Të luftohet stigma në forma më gjithëpërfshirëse.
- Të punohet drejtë akreditimit të degëve tjera psikologjike në UP.
- Të specifikohet mbrojtja e pakicave në ligjin e ri për shëndet mendor.
- Terminologjia në koncept dokumentin për shëndet mendor të rishikohet në mënyrë që të jetë më pak stigmatizuese (si shembull, të mos referohemi si sëmundje mendore, por si çrregullime).
- Të rregullohen çmimet e entiteve private në mënyrë që të jenë më të përballueshme për qytetarët.
- Të promovohen shërbimet online të shëndetit mendor, sidomos me grupe që kanë vështirësi qasjen fizike apo direkte të këtyre shërbimeve (popullata nga zonat e thella rurale, popullata me status ulët socio-ekonomik që kanë vështirësi udhëtimit, apo edhe të mbijetuarit/at e dhunës, etc.).
- Të shfrytëzohen resurset ekzistuese si shkollat, QSHM-të edhe institucionet e ngjashme për promovimin e shëndetit mendor.
- Të zhvillohen kampanja vetëdijesuese për shëndet mendor.
- Të zhvillohen intervenime familjare nga shtëpitë e shëndetit mendor.
- Të punohet në psikoedukimin e mësimitdhënësve në shkolla.